

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush është Indrit Dokle, që u rishpall në kërkim nga SPAK ditën e sotme për akuzat e trafikut të drogës dhe grupit kriminal?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/kush-eshte-indrit-dokle-qe-u-rishpall-ne-kerkim-nga-s-pak-diten-e-sotme-p-i588541
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 13:02:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 13:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b1259ee61969bbf4705ef7d8000638409ad220fb18baec0a2ffdbd7c635c91e4
TEKSTI	3636a23ca847958101b0f4a5063704d03d672667a8abeb6ffb68a15b09720943
PAMJA	8d2300b186e3c01b1d789d3ab7b5e63d626c31f1dfa9ccbc2a4c5ab22c665430

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4c895239da013ac3b05873919c4df5b1f6e5b4ba442e4cb5e6ae1cbc6688a39d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7a6930be9f3749f4980fd84dca137394dacb19a29045da8941f5e341c088ecc2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4c895239da013ac3b05873919c4df5b1f6e5b4ba442e4cb5e6ae1cbc6688a39d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie Kush është Indrit Dokle, që u rishpall në kërkim nga SPAK ditën e sotme për akuzat e trafikut të drogës dhe grupit kriminal? (Bega) pret ambasadorin e ri amerikan Eric V fundit

Kush është Indrit Dokle, që u rishpall në kërkim nga SPAK ditën e sotme për akuzat e trafikut të drogës dhe grupit kriminal?



26 Shtator 2026, 15:00Kronika TEMA



Ish-kreu i një prej fraksioneve të Bandës së Durrësit, kundërshtari i përbetuar i Lulzim Berishës, ishte dënuar me burgim të përjetshëm për krime të rënda, kryesisht vrasje të kundërshtarëve. Në 2020, ai u lirua me kusht nga Gjykata e Krujës. Më herët, gjyqtarja Enkelejda Hoxha, e cila më vonë edhe u dënua, kishte rrëzuar dënimin e përjetshëm për Doklen dhe e kishte dënuar përfundimisht me 25 vite, duke i ndezur edhe dritën jeshile për liri.

Por, teksa paraqitej në Shërbimin e Provës, Dokle shpejt do të rikthehej në botën e krimit. Ai nisi përplasjen e fortë me bosin e bixhozit Ervis Martinajt dhe mes tyre nisi një luftë e ashpër. Luftë që kulmoi me vrasjen e ish-policit Xhelal Reçi, xhaxhait të bashkëshortes së Dokles. Pas këtij momenti, ndaj njerëzve të Ervis Martinajt, që ishte po ashtu në përplasje me disa grupe të tjera, si klani i drejtuar nga Leonard Duka, vëllezërit Durim e Valter Bami etj.

Pas zhdukjes së Martinajt në 2022, dyshimet ranë edhe mbi Indrit Doklen dhe ai u mor në pyetje lidhur me çështjen. Dyshimet rreth tij u ngritën pasi i penduari i drejtësisë, Nuredin Dumani, akuzoi Martinajn se i kishte ofruar gjysmë milioni euro për ta ekzekutuar. Edhe pse i zhdukur pa gjurmë, ndaj Martinajt u ngritën akuzat "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje", në dëm të shtetasit Indrit Dokle, kryer në bashkëpunim të posaçëm të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal dhe organizata kriminale". Të njëjtat akuza u ngritën edhe ndaj Elvin Merlikës, i njohur si krah i djathtë i Martinajt. Dokle, ndërkohë, sipas të dhënave, gjatë kësaj kohe krijoi lidhje të forta me bosë të krimit në Durrës dhe Fier.

Indrit Dokle është nën akuzë zyrtare në kuadër të aksionit "Revanshi" për "Sigurimin e kushteve dhe të mjeteve materiale për të kryer vrasje", në dëm të shtetasit Arben Ndoka, kryer në bashkëpunim të veçantë, atë të grupit të strukturuar kriminal. Ndoka është ish-deputet i PS-së, po ashtu në kërkim. Dokle dyshohet se bashkëpunoi me Durim Bamin për këtë ngjarje.

Dokle akuzohet po ashtu edhe për veprën penale "Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje", në dëm të shtetasve Tori Xheçuka dhe Erigers Mihasi, kryer në bashkëpunim të veçantë, atë të grupit të strukturuar kriminal. Xheçuka ndodhet në kërkim dhe është një prej njerëzve të besuar të Martinajt, ndërsa Mihasi, po ashtu pjesë e grupit të Martinajt, u ekzekutua në një atentat mafioz në Unazën e Re bashkë me Armando Dumanin. Ka dyshime se Indrit Dokle, për disa kohë, u strehua në Dubai.

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[I dënuar me 6 vite burg për prodhim dhe shitje droge, arrestohet 41-vjeçari në Krujë](#)

14:40 Kronika

Detaje nga atentati në Athinë, urdhri u dha nga koka e klanit 'Mafia e Burgjeve'!


13:20 Kronika

[U arrestua me urdhër të SPAK-ut: Kush është Bledar Cafi, i njohur si "i forti i Shkodrës"](#)

13:00 Kronika

[Shembja e godinës në Athinë, motër e vëlla mes viktimave, zbardhen identitetet e shqiptarëve që humbën jetën](#)

11:40 Kronika / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.